

**VENDIM**  
**Nr. 345, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 239, DATË 20.4.2022, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR**  
**FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE**  
**NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË KAVAJË”, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 239, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, nga Bashkia Kavajë për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, në masën 192 095 882 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Kavajë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**